

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në çështjen penale ndaj të pandehurit F.S., nga ..., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s<sup>1</sup>, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.282/2017, të datës 27.02.2017 të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 08.05.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri F.S., nga babai F., e ëma Sh. e lindur E., i lindur më ... në ..., me vendbanim në ..., rrugën ... nr. ..., i martuar baba i dy fëmijëve, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes ekonomike të mesme, shqiptar shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datën 10.02.2017, rreth orës 11.45 minuta, ne Gjilan, në rrugën ” ... ” përkatësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët për shkak të mosmarrëveshjeve familjare, i pandehuri F.S., me dashje ka përdorur forcën ndaj bashkëshortes së tij tani të dëmtuarës B.I., në atë mënyrë që fillimisht e fyen me fjalë të ndryshme ofenduese e më pas e sulmon fizikisht duke e goditur me shuplaka në pjesën e fytyrës, kështu që i pandehuri me veprimet e tij, tek e dëmtuara ka shkaktuar dhembje, frikë dhe shqetësim të madh emocional.

me çka ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s<sup>2</sup>.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton:

### D Ë N I M M E K U S H T

Të akuzuarit F.S., i caktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Në bazë të nenit 453 paragrafi 1 i KPP-s, i pandehuri obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 (njëzet) euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Të akuzuarit i shqiptohet taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej 30.00 € (tridhjetë euro), në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. pagesa e shpenzimeve të procedurës penale.

<sup>1</sup> *Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.*

<sup>2</sup> *Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejshëm KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.*

## ARSYETIM

### 1. Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, me datë 27.02.2017, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 282/2017, kundër të pandehurit F.S., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s<sup>3</sup>. Në shqyrtimin fillestar të datës 08.05.2018, në të cilin ishin prezent Prokurori i Shtetit Shefik Memeti i pandehuri F.S. dhe e dëmtuara B.I.

### 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, dhe të dëmtuarit ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit F.S., për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri F.S., ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s<sup>4</sup>, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin F.S., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-s<sup>5</sup>. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

### 4. Elementet e veprës penale

Në bazë të nenit 187 të KPRK-s<sup>6</sup>, Sulm konsiderohet;

1. Kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, pa pëlqimin e atij personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.

3. Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim me kusht, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që të pandehurit F.S., si rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marrë faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, i njëjti është penduar, dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, e dëmtuara nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka paraqit kërkesë pasuror-juridike

<sup>3</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

<sup>4</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

<sup>5</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

<sup>6</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

ndërsa si rrethana rënduese i ka marr se vepra penale është kryer me dashje dhe lëndimi trupor i shkaktuar të dëmtuarës.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit F.S., duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurin.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nënin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, si dhe taksa për Kompensimin e Viktimave në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 205/2017-Më datë 08.05.2018**

**Sekretarja Juridike**  
Igballe Azemi d.v

**Gjyqtari**  
Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.